

 Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosova	DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS		 Komuna e Istogut Opstina Istok Municipality of Istog
	Nr. i lëndës 11-351-79/21	Datë: 26.11.2021	

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për Procedurën Administrative, Nr. 05/L-031, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura sipas kontratës me nr. prukurimit **633-19-7893-5-1-1/C314** dhe nr. i mbrenshëm **633/019/093/511** në emër të Ndërtimit të Qendrës së Istogut –Rruga “Ibrahim Rugova”, “Fadil Ferati”, dhe rr. e “UÇK-së” Drejtoria për Planifikimit Urban dhe Mjedis në Istog lëshon këtë:

VENDIM PËR LEJE NDËRTIMORE

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	KOMUNA E ISTOGUT (DPUM)		
Adresa:	rr. “Fadil Ferati”nr.21 Istog		
Telefoni:		Emaili:	

Emri i Projektit:	Ndërtimi i Qendrës së Istogut –Rruga “Ibrahim Rugova”, “Fadil Ferati”, dhe rr.e “UÇK-së”		
Emri i Projektuesit:	“Infratek”		
Adresa:	rr.”Ibrahim Rugova”pn. 1400 Lipjan		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:		
Adresa: rr. Rruga "Ibrahim Rugova", "Fadil Ferati", dhe rr. e "UÇK-së"		
Zona(t) Kadastrale: Istog	Nr. i parcelave kadastrale:rrugët kryesore të lartëcekura	GPS Koordinatat:
Lloji i ndërtimit të propozuar:		
Ndërtim i ri ☐ Rindërtim ☒ Riparim ☒		
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:		
Kategoria I ☐ Kategoria II ☒		
Përdorimi i propozuar:		A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po ☐ Jo ☒
Përshkrimi: Ndërtimi i Qendrës së Istogut –Rruga "Ibrahim Rugova", "Fadil Ferati", dhe rr. e "UÇK-së"		

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore Komuna e Istogut i lejohet Ndërtimi i Qendrës së Istogut –Rruga "Ibrahim Rugova", "Fadil Ferati", dhe rr. e "UÇK-së"

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelën informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollat e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;

- Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me KN, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi Komuna e Istogut ka kërkuar nga organi kompetent DPUM lëshimin e Lejes Ndërtimore për Objektin Ndërtimi i Qendrës së Istogut –Rruga “Ibrahim Rugova”, “Fadil Ferati”, dhe rr. e “UÇK-së”. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr.02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Dokumentacioni pronësoreshë juridik
- Tri kopje të projektit ideor dhe kopje elektronike - për Kategorinë e I-rë
- Dëshmi mbi zotimin e mjeteve për pagesën e taksave (NA)
- Te tjera

Shtojcë: Lejes së ndërtimit i bashkëngjitet: situacioni i ngushtë, dispozita urbanistike e pozicionimit të objektit me kordinata, në sistemin koordinativ KOSOVAREF01.

Udhëzim juridik: Pala e paknaqur me këtë vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet MMPHI në Prishtinë Brenda afatit prej 30 ditësh. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI.

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet: parashtruesit të kërkesës kësaj Drejtorie, Drejtorisë për inspektim dhe Arkivës

